

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

## FAKULTETI JURIDIK

### PLANPROGRAMI MËSIMOR NGA LËNDA "E DREJTA PARLAMENTARE"

\*\*\*\*\*

Viti akademik 2019  
Semestri veror

\*\*\*\*\*

Ligjëruesi i lëndës  
Prof.Dr.Arsim Bajrami  
Prof.Dr. Visar Morina  
Prof.Ass.Dr. Murat Jashari  
Dr.Sc Florent Muqaj

\*\*\*\*\*

#### QËLLIMI I LËNDËS

Kjo lëndë ka për qëllim që të familjarizoj studentët e studimeve bachelor me pjesën teorike të së drejtës parlamentare. Në veçanti, studentët do të njihen me institucione e parime themelore parlamentare në një sfond krahasimor. Përveç kësaj studentët do të analizojnë sistemet kryesore të qeverisjes, rolin e parlamentit në këto sisteme, raportin e parlamentit me degët tjera të qeverisjes dhe rolin e parlamentit në zhvillimin e jetës demokratike në përgjithësi.

#### REZULTATET E PRITURA TË NXËNIES

Në përfundim të lëndës, studentët duhet të jenë të aftë të:

- Formojnë pikëpamjet bazë për demokracinë dhe modelet e saja;
- Kuptojnë konceptin e demokracisë;
- Kuptojnë esencën e studimit të demokracisë dhe Parlamentarizmit;
- Të analizojn organet shtetërore dhe funksionimin e tyre;
- Të dallojnë sistemet e qeverisjes;
- Të kuptojn rëndësinë zgjedhjeve parlamentare dhe llojeve tjera të zgjedhjeve;
- Të kuptojn rolin e parlamentit në demokraci

#### METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJES

Metodologjia e mësimdhënies në lëndën Teoria dhe Praktika Parlamentare do mbështetet në aplikimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies siç janë zbatimi i metodave interkative të mësimdhënies, puna ne grupe dhe përfshirja e studentëve në punime me shkrim, aplikimi i prezantimeve vizuale të materialeve si dhe simulimi i rasteve studimore si formë e suksesshme e punës praktike me studentë. Në veçanti studentët do të kenë mundësinë e angazhimit në procesin praktik, përmes vizitave në institucione.

---

## **POLITIKAT AKADEMIKE DHE RREGULLAT E MIRËSJELLJES**

- Përcjellja e ligjëratave dhe ushtrimeve, realizimi detyrave të parapara me plan-programin mësimor;
  - Evidentimi i rregullsisë së vijimit në ligjërata, ndërsa mospjesëmarrja do të tërheq reperkusione në përputhje me dispozitat që dalin nga e drejta e aplikueshme për arsimin e lartë.
  - Metoda e punës me studentët do të jetë interaktive. Ndershmëria akademike duhet të qëndroj në marrëdhënie mësimdhënës-student.
- 

### **Cikli i ligjëratave**

#### **Java 1            Hyrje**

Njoftimi me programin dhe metodat e punës

#### **Java 2            Kuptimi i demokracisë**

- Definimi dhe shtyllat e demokracisë
- Modelet e demokracisë
- Shteti ligjor

#### **Java 3            Parlamentarizmi**

- Kuptimi, lindja dhe zhvillimi i parlamentarizmit
- Krizat dhe sfidat e parlamentarizmit

#### **Java 4            Modelet e sistemeve të qeverisjes**

- Sistemi Parlamentar
- Sistemi Presidencial
- Sistemi Semi-Presidencial

#### **Java 5            Natyra kushtetuese e parlamentit**

- Kuptimi dhe prejardhja e parlamentit
- Funkcionet dhe roli i parlamentit
- Formimi dhe shpërndarja e parlamentit
- Kriza parlamentare

#### **Java 6            Struktura e parlamentit**

- Organizimi i brendshëm
- Parlamenti një dhomësh apo dy dhomësh
- Drejtimi i parlamentit
- Komisionet parlamentare
- Grupet parlamentare

**Java 7            Garancionet kushtetuese të jetës parlamentare**

- Mandati parlamentar
- Imunitetit parlamentar
- Papajtueshmëria parlamentare

**Java 8            Vlerësimi 1**

**Java 9            Roli i shefit të shtetit në sistemin parlamentar**

- Roli i shefit të shtetit në sistemet parlamentare
- Raporti i shefit të shtetit me parlamentin
- Pozita dhe përgjegjësia e shefit të shtetit

**Java 10           Roli i qeverisë në sistemin parlamentar**

- Kuptimi dhe prejardhja e qeverisë
- Qeveria parlamentare
- Raporti i qeverisë me parlamentin

**Java 11           Partitë politike si subjekte themelore parlamentare**

- Paraqitja dhe zhvillimi i partive politike
- Kuptimi i partive politike
- Llojet e partive politike
- Funkcionet e partive politike
- Roli i partive politike në jetën parlamentare

**Java 12           Zgjedhjet parlamentare**

- Roli i zgjedhjeve në demokraci
- Zgjedhjet si instrument i krijimit të legjitimitetit të pushtetit
- Zgjedhjet si instrument i kontrollit politik
- Zgjedhjet si element i pluralizmit politik
- Llojet e zgjedhjeve në demokraci
- Parimet e zgjedhjeve demokratike parlamentare

**Java 13           Sistemet parlamentare në krahasim**

- Sistemi Parlamentar në Britani të Madhe
- Sistemi Parlamentar në Republikën e Gjermanisë
- Sistemi Parlamentar në Republikën e Italisë.

**Java 14           Përfundim**

## **Literatura e rekomanduar**

- Arsim Bajrami, *Parlamentarizmi* (aspekte krahasuese), Prishtinë, 2010

## **Literatura plotësuese**

- Giovanni Sartori, *Ç'është demokracia*, Tiranë, 1998;
- Richard Albert, "The Fusion of Presidentialism and Parliamentarism." *The American Journal of Comparative Law* (2009): 531-578;
- Knut Midgard & Bjorn Erik Rasch, *Demokracia kushtet dhe pasojat*, Prishtinë, 2008;

## **Aktet kushtetuese dhe ligjore**

- Kushtetuta e SHBA-ve
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kushtetuta e Republikës së Francës
- Kushtetuta e Republikës së Italisë
- Ligji Themelor i Gjermanisë
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Veriore
- Ligji nr. 03/1-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës
- Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Rregullorja e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës